



0

Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council



KPK/Nr. 38_/2024

Datë: 15 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 dhe nenit 28 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 15 janar 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Z. Shpëtim Peci, prokuror në Prokurorinë Speciale, transferohet në mënyrë të përhershme në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
- II. Z. Peci transferohet në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nga data 1 mars 2024.
- III. Z. Peci ka të drejtë në beneficinet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 20 dhjetor 2023 ka pranuar nga Prokurori i Shtetit z. Shpëtim Peci kërkesën për transferim, nga Prokuroria Speciale në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për arsye personale e familjare.

Këshilli Prokurorial i Kosovës duke e pasur parasysh vullnetin e prokurorit për transferim, e po ashtu mungesën e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë si dhe situatën e krijuar, bazuar në legjislacionin në fuqi, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Shpëtim Peci, prokuror në PSRK;
- Kryeprokurorit të PSRK-së;
- Kryeprokurorit të PTH Mitrovicë;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së,